



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË GJIROKASTËR

V E N D I M

Nr. 25 Datë. 28/02/2025



“ PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË GJIROKASTËR, SË BASHKU ME DOKUMENTACIONIN TEKNIKO LIGJOR PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FAMILJEN E Z.VASIL KRISTIDHI, I CILI ËSHTË DËMTUAR NGA DJEGIA E BANESËS SË TIJ PRIVATE , SI REZULTAT I RËNIES SË ZJARRIT”

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” , Ligjit Nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile” , Ligjin Nr.9936 , datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” , i ndryshuar, Ligjin Nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” , Udhëzimin Nr.09 , datë 23.03.2018. “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” , V.KM Nr.329 , datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprime njerëzore” , V.K.B Nr. 86 datë 12/12/2024 “Për miratimin e PBA 2025-2027 dhe buxhetit vjetor 2025”, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 28/02/2025

V E N D O S I:

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Gjirokastrë për mbështetjen financiare për shtetasin Vasil Kristidhi, për dëmtimet e banesës së tij si pasojë e djegies.
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Gjirokastrë
3. T’i akordojë familjës së shtetasit Vasil Kristidhi ndihmë financiare në vlerën prej 500.000 (pesëqind mijë) lekë nga fondi i emergjencave civile i destinuar dhe i miratuar nga Këshilli i Bashkisë për vitin 2025 me kod VO91AAC dhe me kod programi AD115, kapitulli 01, artikulli 606.
4. Ndhima financiare për familjen e shtetasit Vasil Kristidhi , përcaktohet sipas kriterëve të V.K.M-së 329, datë 16.05.2022.
5. Ndhima financiare që do të akordohet do të përdoret për krijimin e kushteve për jetesë për Z. Vasil Kristidhi, banesa e të cilit është dëmtuar.

SEKRETAR I KËSHILLIT

Etleva Yzo

KRYETARI I KËSHILLIT

Merita Isaraj